

Me datën 3 prill kryeministri i Shqipërisë zoti Sali Berisha bëri një vizitë në kompaninë Diamant. Gjatë takimit zoti Berisha bëri një vizitë në ambientet e punës së kompanisë dhe më pas një bisedë 20 minutësh me presidentin e kompanisë z. Perikli Goga. Kryeministri u interesua dhe mori një informacion mbi kompaninë Diamant dhe aktivitetin e saj, u diskutuan probleme të transportit, infrastrukurës dhe eksportit në Shqipëri. Gjithashtu, presidenti i kompanisë paraqiti objektivat e kompanisë Diamant për vlerat në vazhdim, të cilat gjëton një mbështetje dhe premtim për angazhim të qeverisë së tij për të beshtetur projektet tona për të kthyer Durrësin në portin e tranzitit për të gjithë Ballkanin. Në këto vizite dhe takim marrin pjesë dhe ministri i Transporteve z. Sokol Ollashi, ministri i Kulturës z. Ferdinand Xhaferri, kryetari i Komunës z. Agim Hoxha, deputeti i zonës z. Osman Metalla, drejtori i përgjithshëm i postave shqiptare z. Arqile Goreja si dhe personalitete të tjera të ekonomisë dhe politikës.